

RELACION

PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË GRANTIT, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS EVROPIANE TË INVESTIMEVE, PËR PROJEKTIN “SHTRATI I LUMIT LANA – ZHVILLIM URBAN””

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Nëpërmjet këtij projektligji synohet ratifikimi i marrëveshjes së grantit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane të Investimeve, për projektin “Shtrati i lumit Lana – zhvillimi urban”, në shumën prej 2,4 milionë eurosh.

Projekti “Vazhdimi i bulevardit “Gjergj Fishta” dhe “Bajram Curri” dhe Rehabilitimi i lumit të Lanës nga Ura Teknologjike deri te kryqëzimi me rrugën “Teodor Keko”” ka për qëllim zgjatimin e bulevardit nga Ura Teknologjike (ku përfundon aktualisht segmenti ekzistues) deri në kryqëzimin me rrugën “Teodor Keko” dhe rehabilitimin e shtratit të Lanës po për këtë segment.

Përmes këtij projekti mundësohet krijimi i një shtrati me regjim hidraulik eficient, për të eliminuar problematikën e përmytjeve në këtë zonë, si dhe duke krijuar hapësirat e nevojshme të zhvillimit urban të zonës.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Ky projektligj nuk është përfshirë në programin e përgjithshëm analitik të projektakteve që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave gjatë vitit 2019.

III. LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Nëpërmjet projektit “Vazhdimi i bulevardit “Gjergj Fishta” dhe “Bajram Curri” dhe rehabilitimi i lumit të Lanës nga Ura Teknologjike deri te kryqëzimi me rrugën “Teodor Keko”” duhet të mundësohet krijimi i një shtrati me regjim

hidraulik eficient, për të eliminuar problematikën e përmbytjeve në këtë zonë, si dhe duke krijuar hapësirat e nevojshme të zhvillimit urban të zonës. Gjithashtu, duhet të zgjaten bulevardet paralel me lumin me të gjithë infrastrukturën e nevojshme, si: sinjalistikën, disiplinimin e ujërave të bardha e të ndotura, ndriçimin, telekomunikacionin, peizazhin, si dhe lidhjen me infrastrukturën ekzistuese. Duhet të parashikohen 2 ura mbi shtratin e ri të lumit për nevojat e zhvillimit urban. Zona që ndikohet nga projekti shtrihet në një sipërfaqe prej 110 ha. Kryesisht ndërtimet përgjatë lumit të Lanës janë ndërtime informale banimi 1-, 2- dhe 3-katëshe, të vetëndërtuara dhe me kushte minimale të banimit. Këto banesa kanë mangësi të theksuara lidhur me infrastrukturën sociale dhe inxhinierike. Lidhjet me rrjetin e ujit të pijshëm shpesh mungojnë dhe ato furnizohen me ujë pusi, i cili mund të jetë i ndotur. Po ashtu, dhe rrjeti i infrastrukturës së ujërave të zeza është informal, kështu që të gjitha kanalizimet janë shpërndarë mbi ose nën tokë. Infrastruktura rrugore është krejtësisht rastësore dhe nuk lidhet me asnjë linjë të transportit publik.

Rehabilitimi i lumit Lana në këtë segment dhe ndërtimi i zgjatimit të dy bulevardeve “Bajram Curri” dhe “Gjergj Fishta” do të ndikojnë pozitivisht në zhvillimin e kësaj zone, duke siguruar një infrastrukturë të qëndrueshme, e cila do t’i shërbejë edhe zonave përreth saj, duke përmirësuar gjendjen tejet të amortizuar të infrastrukturës ekzistuese.

Ky projekt do të zbatohet nga Bashkia Tiranë deri në shkurt 2022.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektligji është në harmoni me Kushtetutën dhe me ligjin nr.43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”.

Marrëveshja e grantit është miratuar në parim nga Këshilli i Ministrave me vendimin nr.403, datë 19.6.2019, dhe është nënshkruar ndërmjet palëve, në përputhje me ligjin 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, dhe do t’i nënshtrohet procedurës së ratifikimit.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Projektligji nuk synon përafrimin e ndonjë *acquis* të Bashkimit Evropian.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektligji parashikon ratifikimin e marrëveshjes së grantit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane të Investimeve, për projektin “Shtrati i lumit Lana – zhvillim urban”, në shumën prej 2,4 milionë eurosh.

Zbatimi i projektit konsiston në një pjesë të punimeve për zgjatimin e bulevardit nga Ura Teknologjike (ku përfundon aktualisht segmenti ekzistues) deri në kryqëzimin me rrugën “Teodor Keko” dhe rehabilitimin e shtratit të lumit Lana po për këtë segment.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTAKTIT

Për zbatimin e projektligjit ngarkohen Bashkia Tiranë dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektligji është hartuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Vlera e grantit në shumën 2,4 milionë euro do të shërbejë për bashkëfinancimin e projektit “Shtrati i lumit Lana – zhvillim urban”, për të cilin BEI-ja akordon edhe një kredi në shumën 8 milionë euro. Nuk parashikohen shpenzime nga buxheti i shtetit.

Nisur nga plani i veprimit dhe i implementimit të këtij projekti, vlera, e cila do të mbulohet nga shpenzimet buxhetore të Bashkisë Tiranë, do të jetë e shpërndarë në 3 vite buxhetore, duke nisur nga viti buxhetor aktual. Kjo vlerë plotëson vlerën e grantit dhe të kredisë, me qëllim implementimin e projektit.

KËSHILLI I MINISTRAVE